



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____._____.2022

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 59/2014 “PËR KARRIERËN
USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 5, shtohen pikat 13 dhe 14, me këtë përmbajtje:

“13. Sportistë të nivelit të lartë” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79, datë 24.06.2017 “Për sportin”, i ndryshuar.

14. “Gradë honorifike” është grada, e ndryshme nga gradat ushtarake të listuara në nenin 12 të këtij ligji, e cila i jepet sportistit të nivelit të lartë.”

Neni 2

Në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) Në pikën 1, germa “ç”, togfjalëshi “Lloji i gradës “Ushtar I”, bëhet “Lloji i gradës “Kadet”;

b) Pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje:

“5. Grada “Kadet” për efekt të pagesës njësohet me gradën “Ushtar I”.

Neni 3

Pas nenit 12, shtohet neni 12/1, neni 12/2 dhe neni 12/3, me përmbajtje, si vijon:

“Neni 12/1 Grada honorifike

1. Sportistit të nivelit të lartë i jepet grada honorifike me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.
2. Propozimi për dhënien e gradës honorifike bëhet nga një komision i posaçëm me përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes dhe një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sportin.
3. Grada honorifike njësohet me gradën e ushtarakut aktiv vetëm për efekt trajtimi me pagë.
4. Sportisti i nivelit të lartë mban gradën honorifike, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji.
5. Grada honorifike i jepet sportistëve të cilët kanë arritur një nga rezultatet e përcaktuara në nenin 12/2 të këtij ligji dhe praktikojnë sport profesionist, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79, datë 24.06.2017 “Për sportin”, i ndryshuar.
6. Pas shkëputjes nga sporti profesionist, sportistit të nivelit të lartë i ndërpritet marrëdhënia financiare me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.
7. Në rastet kur sportisti i nivelit të lartë, mbajtës i njëjës prej gradave honorifike arrin një rezultat më të lartë, sipas të cilit merret një gradë honorifike më e lartë, me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, i jepet grada honorifike më e lartë.

Neni 12/2

Klasifikimi i gradave honorifike

Gradat honorifike, sipas rezultateve si sportist i nivelit të lartë janë:

Rezultati	Grada
a) Sportisti, i cili thyen rekord olimpik/botëror/evropian	Kolonel
b) Vendi i parë deri në vendin e tretë në Lojërat Olimpike/kampionat botëror	Kolonel
c) Vendi i parë në kampionatin evropian	Kolonel
ç) Vendi i dytë deri në vendin e tretë në kampionatin evropian	Nënkolonel
d) Vendi i katërt deri në vendin e gjashtë në Lojërat Olimpike	Nënkolonel
dh) Vendi i shtatë deri në vendin e tetë në Lojërat Olimpike	Major
e) Vendi i katërt deri në vendin e gjashtë në kampionate botërore	Major
ë) Vendi i parë në Lojërat Mesdhetare	Major

Neni 12/3

Ministria e Mbrojtjes mbështet iniciativat për krijimin dhe funksionimin e shoqatave sportive në Forcat e Armatosura. Krijimi, organizimi dhe regjistrimi i tyre, bëhet sipas legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.”

Neni 4

Në nenin 26, pika 1, shkronja “b”, fjalët “kryerjen e një krimi me dashje zëvendësohen me fjalët “një krim të kryer me dashje apo vepër penale të kryer me pakujdesi, e cila cenon figurën dhe integritetin e Forcave të Armatosura”.

Neni 5

Në pikën 2, të nenit 27, pas fjalisë së dytë shtohen fjalët, si më poshtë:

Pas togfjalëshit “Gjatë kësaj periudhe...” shtohen fjalët “...dhe deri në emërimin në detyrë...”

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Lindita Nikolla